



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASENIT LUMOR VJOSË



Nr. 58 / prot.
6

Vlorë, më 22.07.2025

VENDIM

Nr.4 , datë 17.07.2025

PËR

**MIRATIMIN E KËRKESËS PËR AUTORIZIM PËR VEPRIMTARI TË
TJERA NË BRIGJET DHE SHTRATIN E BURIMIT UJOR,
ME VENDNDODHJE: LUMI SHUSHICË, BASHKIA SELENICË,
TË SUBJEKTIT “BASHKIA SELENICË”.**

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 141, të ligjit nr.29/2024, “Për Burimet Ujore”, i ndryshuar, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.319, datë 11.06.2025, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për përdorim burimi ujqor, dokumenteve shoqëruese, procedurës së shqyrtimit e vendimmarrjes, formateve të lejes, autorizimit, kushteve të posaçme dhe afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujqore, Këshilli Basenit Lumor Vjosë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës “Për autorizim për veprimtari të tjera në brigjet dhe shtratin e burimit ujqor”, të subjektit “Bashkia Selenicë”, me vendndodhje: Lumi Shushicë, Bashkia Selenicë, Qarku Vlorë.
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Emri i trupit ujqor: Lumi Shushicë

Koordinatat e Urës (KRGJSH)

1. X=464607.70; Y=4475840.79; Z=73.25
2. X=464506.21; Y=4475860.05; Z=73.25

Lloji i burimit ujqor ku do të kryhet veprimtaria: Lumi Shushicë.

Lloji i veprimtarisë që do të kryhet: Ndërtimi i urës në Fshatin Vodicë mbi Lumin Shushicë.

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujqore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektiv.

KRYETARI I KBL VJOSË

PLATOR NESTURI

